



**SERVIZIO SANITARIO REGIONALE
EMILIA-ROMAGNA**
Azienda Ospedaliera di Reggio Emilia
Arcispedale S. Maria Nuova



Istituto in tecnologie avanzate e modelli assistenziali in oncologia
Istituto di Ricovero e Cura a Carattere Scientifico

Dipartimento Oncologico e Tecnologie Avanzate
Gastroenterologia - Endoscopia Digestiva

Dott. Romano Sassatelli - Direttore

PREPARAZIONE ALLA GASTROSCOPIA PÈRGATITJA PËR GASTROSKOPI

Për analizën e Ezofago-gastro-duodenoskopisë kërkohet që të keni qëndruar pangrënë të paktën tash 6 / 8 orë.

Në qoftë se ekzaminimi kryhet në mëngjes rekomandohet të qëndroni pangrënë që nga mbrëmja e kaluar, pas një darke të lehtë, por në qoftë se ekzaminimi është caktuar pas orës 14.00, lejohet një mëngjes i lehtë, paradite brenda orës 8 të mëngjesit me çaj dhe 2 biskota ose 2 rriska galletë (nuk lejohet qumështi)

Nëse pacienti është diabetik rekomandohet që të qëndrojë pangrënë për të paktën 12 orë.

Në të gjitha rastet lejohet të pini deri në një orë përpara analizës, çaj, ujë ose ujë me sheqer në sasi të vogla.

PER CHI ASSUME FARMACI O E' AFFETTO DA MALATTIE PËR ATA QË MARRIN ILAÇE OSE JANË TË PREKUR NGA NDONJË SËMUNDJE

Përpara analizës është e rëndësishme që të informoni mjekun endoskopist në lidhje me sëmundjet eventuale të rëndësishme, terapitë farmakologjike ose ndonjë alergji.

Në qoftë se merr ilaçe antikoagulantë (Sintrom, Coumadin, antikoagulant të rinj oral...), pacienti duhet të kontaktojë, rreth dhjetë ditë përpara, mjekun e mjekësisë së përgjithshme ose qendrën përkatëse të hemostazës, me qëllim që të paraqitet ditën e ekzaminimit me endoskopi, me një vlerë të INR-së më të vogël se 2 (dozimi duhet të bëhet një ditë përpara ose në ditën e procedurës).

Në qoftë se merr antiagregantë në monoterapi (Aspirinetta, ascriptin, cardirene, tiklid, plavix...) pacienti mund të vazhdojë terapinë duke e pezulluar atë në mëngjesin e procedurës; por në qoftë se merr disa ilaçe antiagregantë (p.sh. aspirinë + clopidogrel...) këshillohet që t'ia referojë mjekut të tij të mjekësisë së përgjithshme ose kardiologut të tij, në lidhje me mundësinë e pezullimit të përkohshëm të njërës prej dy ilaçeve.

Në ditën e ekzaminimit pacienti mund të ndjekë marrjen e terapive që ka në vazhdim e sipër (ilaçe për zemrën, frymëmarrjen, presionin e gjakut, qarkullimin, antiagregues, etj); megjithatë ilaçet nuk duhet të merren një orë përpara se të fillojë ekzaminimi endoskopik.

Në qoftë se pacienti është alergjik ndaj lateksit duhet të kontaktohet sekretaria ose koordinatori i shërbimit të paktën një javë më përpara.

Në rast dyshimi pacienti mund t'i drejtohet shërbimit të gastroenterologjisë dhe endoskopisë digjestive për të marrë udhëzimet përkatëse.

RACCOMANDAZIONI GENERALI REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME

Përpara analizës, eventualisht, duhet të hiqen protezat e lëvizshme dentare.

Duhet të merrni me vete dokumentet tuaja të mëparshme shëndetësore në lidhje me kontrollin endoskopik.

Nëse pacienti dëshiron të bëjë një gastroskopi me anestezi, ai duhet të jetë detyrimisht i shoqëruar, meqenëse gjatë 12 orëve të ardhshme nuk duhet të kryejë aktivitete që kërkojnë gatishmërinë e refleksive, si për shembull kur drejton një automjet ose edhe kur ecën vetëm në rrugë i pashoqëruar.

Gastroenterologia - Endoscopia Digestiva

Viale Risorgimento, 80 — 42123 Reggio Emilia
T. +39.0522.296423 F. +39.0522-296266
sassatelli.romano@asmn.re.it - www.asmn.re.it

sede legale: Viale Umberto I°, 50 — 42123 Reggio Emilia
T. +39.0522.296111 F. +39.0522.296266
Partita IVA 01614660353